



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo - Republika Kosova



Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit
Telecommunications Regulatory Authority
Regulativni Autoritet Telekomunikacije

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Njoftim nga Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit (ART) mbi zhvillimet kryesore në tregun e telekomunikimeve gjatë vitit 2011

Qëllimi i kësaj deklarate për shtyp është që të raportoj në formë të përmbledhur zhvillimet kryesore në fushën e telekomunikacionit dhe të sektorit postar në Republikën e Kosovës për vitin 2011, të dhëna këto tashmë të publikuara në detaje edhe me raportin vjetor të punës së ART-së të paraqitur për vëmendje të Kuvendit të Kosovës dhe të publikuar në ueb faqen e ART-së. Në mënyrë specifike do komunikohen dhe jepen vlerësimet mbi ecurinë e treguesve kryesor të tregjeve të telekomunikacionit duke krahasuar etapat e ndryshme kohore dhe zhvillimeve kryesore rregullatore.

Tregu i telekomunikacionit në Kosovë gjatë vitit 2011 shënoi një rritje prej 7.65% duke arritur vlerën totale prej mbi 239 milion €. Një normë e lartë rritjeje prej 9.94% u shënuar në tregun e telefonisë mobile duke përfaqësuar 83.19% të tregut të përgjithshëm të telekomunikacionit. Tregu i dytë me radhë për nga të ardhurat është ai i telefonisë fikse, që përbën një vlerë totale të tregut prej mbi 20 milion € (ose një rritje prej 0.67%) me vetëm 8.37% të të ardhurave nga tregu i përgjithshëm i telekomunikacionit, ndërsa interneti dhe linjat me qira kanë shënuar një rënie prej 4.93% dhe 1.7%, respektivisht. Rritja në të ardhurat nga shërbimet e telekomunikimeve, ka rezultuar gjithashtu me një rritje të investimeve në sektor. Duke u bazuar në të dhënat e mbledhura nga operatorët mobil, operatorët e rrjetit fiks, ofruesve të shërbimit të internetit dhe atyre të linjave me qira, investimet e përgjithshme në tregun e telekomunikimeve gjatë vitit 2011 arritën shifrën prej mbi 38 milion €, e që paraqet një rritje prej 24.33% krahasuar me vitin 2010.

Përveç kësaj, pasqyra e përgjithshme nga tregu i telekomunikimeve tregon se numri i përgjithshëm i përdoruesve të internetit po përjeton një rritje të theksuar. Vetëm në fund të vitit 2011, numri i përgjithshëm i përdoruesve të internetit ishte 143,243 që paraqet një rritje substanciale prej 13.31% krahasuar me numrin e përdoruesve në fund të vitit 2010. Gjithashtu, mesatarja e penetrimit të shërbimeve të internetit ka shënuar një rritje të konsiderueshme nga 6.33% sa ishte mesatarja e penetrimit në vitin 2010, në mesatare të penetrimit prej 7.92% (në fund të vitit 2011 penetrimit i internetit ka arritur vlerën 8.26% për banor ose 48.55% për njësi rezidenciale /shtëpi), e që nënkupton një rritje prej 25,12% të normës së penetrimit.

Sa i përket aspektit rregullator, në vijim në mënyrë kronologjike janë paraqitur të arriturat kryesore dhe progresi i bërë nga ART në nxjerrjen dhe kompletimin e legjislacionit sekondar (kornizës rregullatore) gjatë vitit 2011;

- Aprovimi i Planit Kombëtar për Shpërndarjen e Spektrit të Frekuencave; Tabela Kombëtare për Shpërndarjen dhe Përdorimin e Spektrit të Frekuencave në brezin frekuencor 9kHz deri 275 kHz e aprovuar nga ana e Parlamentit të Kosovës.
- Aprovimi i autorizimit individual për të drejtën e përdorimit të brezit frekuencor 2x10MHz në brezin 1800 MHz për nevojat e komunikimeve mobile në Republikën e Kosovës për operatorin PTK Sh.A/Vala,
- Nxjerrja e gjashtë rregulloreve të reja dhe mbi pesëdhjetë vendimeve rregullatore,
- Themelimi dhe funksionalizimi i plotë i Nyjës së parë Shkëmbyese të Internetit në Kosovë - e njohur si KOSIX.
- Inkasimi i të hyrave në vlerë prej mbi 18 milion €, e që përfaqëson një rritje të ndjeshme në krahasim me të ardhurat e planifikuara për vitin 2011 për rreth 13.2%,
- Përmbyllja me sukses e procesit të Analizës Tregut për Telefoninë Fikse dhe fillimi i implementimit të masave rregullatore ndaj operatorëve me fuqi të ndjeshme në treg,
- Funksionalizimi i sektorit të Shërbimit Postar pranë ART-së dhe fillimi i rregullimit të tregut postar,
- Kontributi me ndihmë profesionale dhe teknike-konsultative në/gjatë procesit të dialogut teknik të Kosovës në lidhje me temën e telekomunikacionit.

Kreu i Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit, z. Hoxha, pohon se viti 2012 në këndvështrimin rregullator do jetë vit që do shënon përmbylljen e ciklit të parë të analizave të të gjitha tregjeve të telekomunikimeve dhe fillimin e implementimit të masave rregullatore që synojnë krijimin e një tregu me një konkurrence plotësisht efektive të shërbimeve dhe produkteve dhe njëherazi liberalizim të mëtutjeshëm të tregut të telekomunikimeve me hyrjen në fuqi të Ligjit për Komunikime Elektronike, i cili mes tjerash si risi kryesore do ketë kalimin nga regjimi i licencimit individual në atë të autorizimit të përgjithshëm, gjegjësisht notifikimit, i cili do bëjë të mundur eliminimin e barrierave për hyrje në treg.

ART si edhe deri më tani do të bëjë përpjekjet e duhura për të qenë në linjë me risitë dhe zhvillimet më të reja në fushën e telekomunikacionit në nivelin rajonal dhe ndërkombëtar, duke qenë i përkushtuar për të kuptuar nevojat e operatorëve dhe duke përcjellur e kontribuar në mënyrë aktive në transpozimin e legjislacionit sekondar rregullator në veçanti atij afat-shkurtër që ndërlidhet me konvergjencën e teknologjive digjitale të telekomunikacionit.